



Organizata për Siguri dhe  
Bashkëpunim në Evropë  
**Prezenca në Shqipëri**

**FJALA E KRYETARIT TË PREZENCËS, AMBASADORIT EUGEN WOLLFARTH  
NË TAKIMIN E KOMITETIT EKZEKUTIV  
TË SHOQATËS SË KOLEGJEVE EVROPIANE TË POLICISË  
Hotel "Tirana International", 18 janar 2012**

Drejtor i Përgjithshëm Burgaj,  
President, Z. Petit,  
Drejtor Fjora,  
Përfaqësues të Kolegjeve Evropiane të Policisë,  
Zonja dhe Zotërinj,  
Mirëmëngjesi.

Më vjen shumë mirë që jam këtu së bashku me ju sot.

Besoj se ky është takimi i parë që Shoqata po mban në Shqipëri

Kjo i jep edhe me shumë rëndësi takimit të sotëm.

Ky takim do t'ju mundësojë që të takoni homologët tuaj shqiptarë për të parë se realiteti shqiptar është në gjendje që të përshtatë sa më mirë seancat e ardhshme të trajnimit.

President Petit, Shoqata juaj sigurisht që nuk është e re.

Krijuar në vitin 1996, një nismë e Akademive të Policisë Britanike, Holandeze dhe Gjermane, besoj se Shoqata juaj ka vepruar gjatë gjithë kësaj periudhe në mënyrë shumë fisnike dhe të suksesshme si një rrjet për drejtorët e akademive të policive Evropiane.

Sot, kjo Shoqatë përbëhet prej rreth 50 Kolegjesh të Policisë nga rreth 42 vende. Të gjitha këto vende janë vende anëtare të OSBE-së.

Synimi juaj ka qenë që të asistoni shërbimet e policisë Evropiane që të ofrojnë policimin më të mirë të mundshëm për komunitetet e tyre përkatëse ndërsa adresojnë gjithashtu sfidën e krimit në nivel ndërkombëtar.

Ju vazhdoni të përpiqeni që të rrisni në maksimum bashkëpunimin lidhur me asistencën për trajnimin e policisë midis kolegjeve anëtare, që të lehtësoni ndarjen e praktikave më të mira, për të mundësuar shkëmbim më të madh të studentëve dhe stafit dhe për të paraqitur lidhje të teknologjisë së informacionit midis kolegjeve.

Këto janë vërtet punë të rëndësishme ashtu siç janë parimet e Shoqatës suaj: 'fleksibilitet', 'thjeshtësi' dhe 'sa më pak burokraci'.

Për sa i takon bashkëpunimit, besoj se Shoqata juaj ka arritur disa momente vërtet të rëndësishme.

Për shembull: zbatimi i një programi trajnimi që asiston vendet Kandidate në Evropën Qendrore dhe Lindore gjatë përgatitjeve të tyre për anëtarësim në BE dhe që ofron module trajnimi për vendet e Evropës Juglindore brenda kuadrit të Paktit të Stabilitetit.

Ç'është më e rëndësishme, në të shkuarën, ndihet se në disa zona kishte ndodhur dublikimi i përpjekjeve, për shembull për sa i takon organizimit të Drejtuesve të konferencave trajnuese për Evropën Lindore dhe Perëndimore.

Do të sugjeroja që Shoqatës suaj t'i atribuohen meritat për marrjen e nismës për të unifikuar të dy aktivitetet në një konferencë të vetme.

Zonja dhe zotërinj,

Këto janë vetëm disa shembuj që theksojnë rezultatet e arritura nga Shoqata.

Nëse i kthehem tani, edhe pse shkurtimisht, organizatës sime, mendoj se është e rëndësishme dhe e nevojshme të them që duke punuar ngushtësisht si me PAMECA-n dhe ICITAP-in, Prezenca e OSBE-së ka vazhduar përgjatë shumë viteve që t'i ofrojë Policisë së Shtetit asistencë teknike për të ndihmuar forcimin e aftësisë së saj për t'u bërë një organ policor më modern dhe profesional.

Prandaj, lidhur me këtë, mbështetja për trajnime është sigurisht shumë thelbësore.

Është e qartë, si në përmbajtje ashtu edhe në formë, që shërbimet policore të të gjitha vendeve duhet të trajtohen në mënyrën e duhur në mënyrë që të kenë personat më të zotë në pozicionet e duhura.

Mund të them se në Shqipëri gjërat po ecin në drejtimin e duhur dhe për këtë i duhet dhënë meritë Drejtorit të Përgjithshëm Burgaj dhe drejtuesve të lartë që punojnë me të.

Megjithatë, asnjë prej nesh nuk mund të mendojë se një trajnim specifik i ofruar sot, nesër apo pas një jave, do të zgjidhë përfundimisht një objektivë specifike organizative.

Për këtë arsye, mbështetja me trajnime duhet parë si një proces i vazhdueshëm të cilit nuk i vjen asnjëherë fundi, ose, nëse parapëlqeni, me një horizont gjithmonë e më të gjerë.

Ju e dini më mirë se unë që një trajnim i zbatuar dobët ose i papërfunduar faktikisht mund të shkaktojë shumë dëme.

Për sa i përket shërbimit policor, oficerët e policisë që nuk janë trajnuar siç duhet dhe/apo sa duhet, nuk mund të jenë "profesionistë të mirë" dhe nuk do të jenë në gjendje të punojnë në mënyrë efektive me kolegët e tyre apo me komunitetin lokal ku punojnë.

Kështu që të gjithë shërbimet policore duhet të jenë në gjendje të ofrojnë trajnimin e duhur për punonjësit e duhur të policisë, në kohën e duhur.

Unë besoj se ky është një detyrim i qartë institucional, moral dhe profesional.

Duke thënë këtë, në botën e sotme, asnjë punonjës policie nuk mund të injorojë përvojën e kolegëve nga shërbimet e tjera policore.

Por për çfarë bëhet fjalë sot këtu për të gjithë ne që jemi të fokusuar në mbështetjen e zhvillimit të trajnimeve të shërbimeve policore?

Në Shqipëri, objektivi është të arrihet vazhdimësia e sigurisë së të gjithë qytetarëve në mbarë territorin.

Për të arritur këtë objektiv, nevojitet një përforsim i vazhdueshëm i "marrëveshjes së mirëbesimit" midis policisë dhe qytetarëve.

Për këtë bëhet fjalë: për një marrëveshje mirëbesimi!

Duke filluar që nga Policia e Shtetit deri te punonjësi më i thjeshtë i policisë asgjë me vlerë dhe thelbësore nuk mund të arrihet pa besimin e publikut shqiptar.

Trajnimi është një parakusht kyç.

Trajnimi i pajis punonjësit e policisë me instrumentet përkatëse që të kryejnë në mënyrë profesionale detyrat e tyre për të fituar besimin, dhe po e përsëris dhe një herë 'besimin', e publikut dhe për të shërbyer në interes të tyre – për t'i shërbyer 'interesit publik'.

Shoqata Evropiane e Kolegjeve të Policisë është treguar e zonja për të shtruar rrugën e zhvillimit të teknikave të reja dhe për të promovuar mënyra të reja trajnimi – për të futur një përfaqje moderne *evropiane*.

Duke marrë gjithë këtë në konsideratë, duhet të them se Prezenca do të jetë e gatshme të punojë me Shoqatën Evropiane të Kolegjeve të Policisë dhe të zhvillojë çdo lloj bashkëpunimi në të mirë të Policisë së Shtetit Shqiptar.

Më vjen mirë që Akademia e Policisë së Shtetit Shqiptar është anëtare e Shoqatës.

Nuk kam asnjë dyshim që ky anëtarësim do të vazhdojë t'i shërbejë policisë shqiptare edhe në të ardhmen, ashtu si tashmë ka filluar t'i shërbejë!

Drejtor i Përgjithshëm Burgaj,  
President Petit,  
Drejtoreshë Fjora,  
Përfaqësues të Kolegjit Evropian të Policisë,

Më lejoni të përsëris edhe një herë kënaqësinë që jam këtu me ju sot dhe t'i uroj të gjithë kolegjeve të pranishëm një takim të suksesshëm.

Faleminderit

**Fund**

*KONTROLLO PËRKUNDREJT FJALIMIT TË MBAJTUR*